



www.legjislatiioni.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 10

Tiranë – E hënë, 20 korrik 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i ministrisë së Financave nr. 10655, datë 15.7.2015	Për shitje..... 3



NJOFTIM I MINISTRISË SË FINANCAVE

Nr. 10655, datë 15.7.2015

REPUBLICA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVEDREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E DREJTIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Në zbatim të VKM Nr. 926, datë 29.12.2014 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, shpall për shitje me vëm fillestar si më poshtë:

1. Në administrim të Drejtorisë Rajonale të Rrugëve Shkodër

Emertimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i Ankandit		
		Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
Ndërtesa e grupit Bushat, Sektori Shkodër	Bushat, Shkodër	876 131	846 415	29 716	76	39.13	12.08.2015	09.00	DDPP

2. Në administrim të Bashkisë Ersekë

Emertimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i Ankandit		
		Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
Reparti i marangozit	Ersekë	1 140 540	980 580	159 960	120	100	12.08.2015	10.00	DDPP

3. Në administrim të “Berateks” sh.a Berat

Emertimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i Ankandit		
		Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
Magazina e sulfatit dhe sipërfaqe funksionale	Berat	18 749 052	4 931 796	13 817 256	3 768	578	12.08.2015	11.00	DDPP



4. Në administrim të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarjes

Emertimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i Ankandit		
		Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
“Depo”	Libonik, Korçë	44 939 366.55	44 018 754.05	920 612.50	3 917.5	2 254.32	12.08.2015	12.00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.
2. **Mandat pagesën apo Garancinë bankare** në origjinal që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20 % të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave.
3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shenim: Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20 % e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarja duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.
2. **Mandat pagesën apo Garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 përqind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (Mjetekryesore), për llogari të Ministrisë së Financave në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.
3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.
4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokure përfaqësimi etj. nëse ka të tilla.
5. **Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish- Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandat pagesa apo Garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandat pagesa apo Garancia bankare apo mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave pasi të keni tërhequr pranë DDPP ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave www.financa.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.